

Ne bazë të nenit 12, paragrafi 2, pika (d) dhe nenit 40, të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr-03/L-040, publikuar në (Gazeta zyrtare 28/2008), neneve 27, 28 dhe 29, pika 2 të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, nenit 77, të Ligjit për Procedurën Administrative, Nr-02/L-28, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur më, 26.04.2012, miratoi këtë:

RREGULLORE E PUNES TE GRUPIT TË GRAVE ANËTARE TË KUVENDIT TE KOMUNËS SË SUHAREKËS

Neni 1.

Qëllimi

Të nxitura për të diskutuar dhe trajtuar nevojat dhe problemet e gruas në Komunën e Suharekës;

Të vendosura për të mbrojtur dhe përfaqësuar interesat më të mira të gruas, dhe për të qenë zëri i të gjitha grave në Institucionet e Komunës së Suharekës;

Të përkushtuara për të punuar në arritjen e objektivit që synon rritjen e pjesëmarrjes aktive të femrave në Komunën e Suharekës;

Me synimin për fuqizimin dhe konsolidimin e mëtejshëm të Grupit të grave anëtare të Kuvendit të Komunës (asamblistë)

Për të arritur të gjitha qëllimet dhe synimet të përcaktuara më sipër;

Me këtë rregullore përcaktohet kompetenca, organizimi i punës dhe mënyra e funksionimit të Grupit të grave anëtare të Kuvendit të Komunës, pa dallim feje, race dhe etniteti.

Neni 2

Data e themelimit

Grupi i grave, anëtare të Kuvendit të Komunës është themeluar me vendimin e Kuvendit të Komunës në Suharekë, 01-Nr-16-7362, të datës 30.11.2011, me qëllim që të ndihmojë në arsimimin, emancipimin dhe avancimin e pozitës së gruas në Komunën e Suharekës.

Neni 3

Vendndodhja

Grupi i grave, anëtare të Kuvendit të Komunës, pikë kontaktuese e ka zyrën për barazi gjinore në Komunë.

Neni 4

Grupi i grave, anëtare të Kuvendit të Komunës angazhohet

- 4.1 Për fushat që kanë të bëjnë me barazinë gjinore dhe ngritjen e gruas në të gjitha sferat e jetës.
- 4.2 Hartimin e planit të punës për aktivitetet që kanë të bëjnë me Grupin e Grave asamblistë.
- 4.3 Hulumtimin dhe konstatimin e pozitës së vajzave dhe grave në Komunën e Suharekës.
- 4.4 Ofron rekomandime tek Zyra për të Drejtat e Njeriut, për hartimin e politikave të reja për barazi gjinore, në pajtim me ligjin në fuqi.
- 4.5 Mbështet bashkëpunimin kulturë-shoqëri, në mes të institucioneve shoqërore rajonale dhe lokale me institucionet publike dhe private që merren me çështje të sferave të ndryshme që kanë të bëjnë me çështjet gjinore.
- 4.6 Shqyrton propozimet dhe inicion planet lokale për barazi gjinore.
- 4.7 Propozon masat e nevojshme për realizimin e programeve shëndetësore , kulturore, arsimore dhe çështje gjinore.
- 4.8 Bazohet në Konventat dhe instrumentet tjera ndërkombëtare për të përmirësuar dhe avancuar pozitën e gruas.
- 4.9 Bashkëpunon dhe bashkërendon aktivitetet, me Grupin e Grave në Kuvendin e Kosovës dhe komunave tjera, Agjencinë për Barazi Gjinore dhe të gjithë mekanizmat tjerë, të cilët promovojnë barazinë gjinore.

Neni 5

Zgjedhja e organeve dhe kompetencat e Kryetares

- 5.1. Grupi i grave, anëtare të Kuvendit të Komunës zgjedh Kryetaren, zëvendëskryetaren dhe sekretaren.
- 5.2. Në parim , mbledhjet e grupit të Grupit të grave, anëtare të Kuvendit të Komunës mbahen një herë në muaj dhe sipas nevojës edhe më shumë. Mbledhjet kryesohen nga Kryetarja, kurse në mungesë të saj nga zëvendëskryetarja.

5.3. Në rast të mungesës së paarsyeshme të çdo anëtareje të Grupit të grave, anëtare të Kuvendit të Komunës tri herë radhazi në mbledhjet, ajo shkarkohet pa procedurë

5.4. Në rast të mungesës së zyrtares për Barazi Gjinore, ajo duhet të caktojë përfaqësuesin e vet të autorizuar, për pjesëmarrje vetëm për atë mbledhje të grupit të gruas.

5.5. Zyrtaret dhe personat tjerë që nuk janë anëtare të Grupit të grave, anëtare të Kuvendit të Komunës, por që janë të pranishëm në mbledhje, do të lejohen nga ana e Kryesueses të flasin dhe t'i paraqesin qëndrimet dhe propozimet e tyre.

5.6. Kryesuesja e Grupit të grave, anëtare të Kuvendit të Komunës, mund të urdhërojë ndonjë anëtare ose zyrtarë tjetër të cila sipas mendimit të saj bënë veprime që prishin rendin gjatë mbledhjes dhe që janë në kundërshtim me kodin e sjelljes që t'i përmbahen rregullave të punës. Në rast se anëtarja ose zyrtari tjetër edhe pas urdhrit që t'i përmbahet rregullave të punës në mbledhje, vazhdon t'i shkelë rregullat e punës, kryesuesja mund ta urdhërojë që ta lëshojë mbledhjen vetëm për atë takim.

Neni 6

Shqyrtimi i propozimeve

6.1. Shqyrtimi i ndonjë propozimi nga ndonjë anëtare e Grupit të grave, anëtare të Kuvendit të Komunës, Zyrtarja për Barazi Gjinore ose nga institucionet dhe shoqatat e ndryshme, do të bëhet në pajtim me rendin si vijon:

6.2 Propozuesja, do të flasë e para, në afat kohor prej 5 min, në raste të veçanta mund zgjatet afati deri në 10 min.

6.2 Zyrtarja për barazi Gjinore, do të ketë të drejtë të flasë e dyta dhe Kryesuesja e treta dhe anëtarët e grupit sipas radhës në afat kohor 3 min.

6.4 Në fund të debatit, propozuesja do të ketë të drejtë të përgjigjet dhe të bëjë komente dhe pastaj kryesuesja e përmbys debatin.

Neni 7

Diskutimi

Një anëtare e Grupit të grave, anëtare të Kuvendit të Komunës, mund të diskutojë për një çështje vetëm një herë gjatë rrjedhës së një debati, për një pikë të rendit të ditës, me qëllim të qartësimit dhe të sqarimeve apo të dhënies së përgjigjeve do të ketë të drejtë edhe një herë të diskutojë. Fjalimet e anëtareve të grupit zgjasin më së shumti pesë minuta.

Neni 8

Rregullat

Kryesuesja duhet të kujdeset që ta mbajë rendin gjatë takimeve. Anëtarët e Grupit të grave, anëtare të Kuvendit të Komunës, zyrtarët dhe personat tjerë janë të detyruar të respektojnë rregullat e punës dhe t'i zbatojnë urdhrat eventuale të kryesueses së Grupit të grave, anëtare të Kuvendit të Komunës.

Neni 9

Caktimi i rendit të ditës

9.1. Kryesuesja e Grupit të grave, anëtare të Kuvendit të Komunës, në bashkëveprim me anëtarët e grupit propozon rendin e ditë për mbledhje.

9.2. Për çështjet e rendit të ditës për të cilat nuk mund të arrihet pajtimi, mund të barten në mbledhjen e ardhshme, kurse Kryesuesja ndërkohë duhet të zhvillojë konsultime për të arritur pajtime për çështjen e bartura

Neni 10

Vendimmarrja

10.1. Grupi i grave, anëtare të Kuvendit të Komunës, nuk është trup vendim-marrës. Për çështjet e shqyrtuara mund të bëjnë rekomandim Zyrës për Barazi Gjinore dhe Kuvendit të Komunës, duke dhënë arsyetime përkatëse

10.2. Rekomandimet për ndonjë çështje me rëndësi Grupi i grave, anëtare të Kuvendit të Komunës, mund t'i dërgoj edhe institucioneve tjera vendimmarrëse si në Kuvendin e Kosovës, Qeverinë e Kosovës dhe Agjencinë për Barazi Gjinore.

10.3. Nëse për një çështje të caktuar duhet të votohet, vendimi duhet të merret me shumicë votash të anëtareve të pranishme të Grupit të grave, anëtare të Kuvendit të Komunës .

10.4. Votimi bëhet me vota të hapura. Në rast të numrit të barabartë të votave , kryesuesja e ka një votë shtesë.

Neni 11

Transparenca dhe konfidencialiteti

Takimet e Grupit të grave, anëtare të Kuvendit të Komunës, janë të hapura si për mediat, ashtu edhe për palët e interesuara, përveç nëse Grupi i grave, anëtare të Kuvendit të Komunës vendos ndryshe.

DISPOZITAT KALIMTARE PËRFUNDIMTARE

Neni 12

Për zbatimin-implementimin e kësaj rregullore do te kujdeset Grupi i grave, anëtare të Kuvendit te Komunës dhe zyra për barazi gjinore e Komunës.

Neni 13

Kjo rregullore miratohet ne Kuvendin e Komunës së Suharekës, konform procedurave ligjore.

Neni 14

Grupi i grave, anëtare të Kuvendit te Komunës e analizon vazhdimisht rregulloren e punës dhe kohë pas kohe mund t'i propozojë Kuvendit të Komunës në Suharekës për ndryshime-plotësime në procedurë të njëjtë të miratimit.

Neni 15

Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës në Suharekë kjo rregullore hyn ne fuqi 8, ditë pas dërgimit në autoritetit mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit mbi qeverisje lokale, nr -03 L -040, (Gazeta zyrtare 28/2008)

KUVENDI I KOMUNËS SË SUHAREKËS

01-Nr-_____

Data_____

Kryesuesi i Kuvendit

Vesel Maliqaj